

JEMI NE ATA QË



UDHËHEQIM

FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS


MEDINA K. (11), QËNDRIM (10), ERZA (10), MEDINA M. (11), RINOR (10), LEONIT (11), ARIS (10)



Rregullat dhe ligjet në Republikën e Kosovës dhe në Kuvendin e saj

Kuvendi ndryshe quhet „Shtëpia e popullit“. Quhet kështu sepse njerëzit që punojnë aty, pra deputetët janë zgjedhur nga populli dhe për popullin. Ata mbledhen në Kuvend për një qëllim, e ky qëllim është të punojnë për të mirën e popullit.

Deputetët kanë detyrë kryesore votimin e ligjeve, dhe



këto ligje që ata i bëjnë shërbejnë për të mirën e popullit. Një nga ligjet që ndikon direkt tek fëmijët është ligji për çështje të arsimit. Deputetët në Kuvend përveç se miratojnë, shfuqizojnë dhe propozojnë ligje, ata po ashtu zgjedhin dhe kontrollojnë Qeverinë si dhe zgjedhin Presidentin.

Në Kuvend ka 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë qytetarë shumicë, të cilët janë shqiptarë. Kurse 20 të tjerë janë qytetarë të komuniteteve jo shumicë, të cilët janë

serbë, boshnjakë, romë, ashkalinjë, turq etj.

Funksionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ, dhe funksioni i kontrollit. Për secilin nga këto funksione ka nga një shpjegim. Kuvendi ka funksion përfaqësues, sepse deputetët që punojnë aty përfaqësojnë popullin. Funksioni legjislativ është për shkak se ata bëjnë ligje, dhe funksioni kontrollues sepse ata kontrollojnë Qeverinë. Në Kuvendin e Kosovës mbahen seancat plenare. Këto seanca mund të jenë rregullta dhe të jashtëzakonshme. Seancat e rregullta mbahen në ditën e enjte, kurse seancat e jashtëzakonshme mbahen sipas rasteve të jashtëzakonshme. Deputetët në Kuvendin e Kosovës votojnë në tri mënyra. Këto mënyra janë votimi me shkrim, me dorë dhe në mënyrë elektronike. Forma më e përhapur është votimi elektronik, kurse votimi me shkrim ndodh në rastet kur deputetët e zgjedhin Presidentin.



Gazetarët e këtij artikulli

UDHËHEQËSIT E RINJ TË DEMOKRACISË


DEBATIK (10), FATLUME (10), RIJAD (10), ELDA (10), ADHURIM (12), SHKURTA (11), GENT (10)

Demokracia është forma më e mirë e qeverisjes që kemi pasur ndër vite

Fjala demokraci rrjedh nga fjala greke, nga e cila „demos“ do të thotë popull, ndërsa „kratos“ qeverisje, pra ajo do të thotë qeverisje e popullit. Vet fjala demokraci simbolizon paqen, barazinë, dashurinë, harmoninë, respektin, lirinë, tolerancën e shumë gjëra të tjera. Të gjithë qytetarët duhet të votojnë dhe të shprehin mendimet e tyre, qoftë ata me nevoja të veçanta apo me ndonjë veçanti tjetër. Demokracia është formuar në vitin 507 para erës së re. Demokracia ndahet në dy forma: në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Të gjithë ne jemi të barabartë pa dallim feje, race, kombësie, gjinie etj. Ne e duam demokracinë dhe besojmë në demokraci, sepse ne ndihemi të barabartë. Ne duam që të gjithë fëmijët e botës ta respektojmë njëri-tjetrin, ta duam njërin-tjetrin si dhe ta duam demokracinë.




Gazetarët e demokracisë



Këto janë elementet e demokracisë



Të barabartë pa asnjë dallim



Format e demokracisë



Kosova demokratike

VOTA IME SJELL NDRYSHIM

AGNESA (10), BLINERA (10), ENSARI (10), ERZA (10), LORIKU (11), SAMET (10)



Përmes zgjedhjeve secili qytetar e jetëson të drejtën e votës së lirë

Populli ynë është një popull i cili i gëzon shumë të drejta, sepse ne kemi udhëheqje demokratike, ku secili qytetar ka lirinë për të zgjedhur dhe për t'i shprehur lirshëm opinionet e veta. Ne e dimë që jo vetëm populli ynë ka udhëheqje demokratike, por si ne ka edhe shumë të tjerë.

Ajo çka vendin tonë e bën vend demokratik është e



Një zgjedhje e përditshmërisë tonë

drejta për të shprehur lirshëm mendimin tonë, e drejta për të zgjedhur si dhe e drejta për t'u zgjedhur.

Me fjalën zgjedhje kuptojmë mundësinë e zgjedhjes mes dy apo më shumë opsioneve. Zgjedhjet janë forma demokratike për të arritur në pushtet. Por, si arrihet kjo?

Kjo arrihet përmes votave të popullit sepse ne zgjedhim atë që mendojmë se është më i përgjegjshëm.

Por ne bëjmë edhe në përditshmeri shumë zgjedhje. Si për shembull: ushqimet, veshjet, punët, etj. Të drejtën për të zgjedhur e ka çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare. Pse mbi moshën 18 vjeçare ?

Pasi që mbi moshën 18 vjeçare ne jemi më të pjekur, dhe më të zhvilluar dhe jemi të aftë të gjykojmë se kush është më i miri për ne.

Kosova ka dy lloje zgjedhjesh. Zgjedhjet lokale dhe qendrore. Në zgjedhjet lokale qytetarët i votojnë kandidatët për Kryetar të komunës si dhe Asamblenë komunale. Ndërsa, në zgjedhjet qendrore qytetarët i votojnë kandidatët për deputetë nga parti të ndryshme politike. Pra, nga kjo ne po e kuptojmë rëndësinë e madhe që zgjedhjet kanë në jetën tonë. Sepse përmes zgjedhjeve, ne qytetarët jemi pjesë e bashkëqeverisjes së vendit tonë. Çdo qytetar e ka rëndësinë e vet në vendin ku jeton dhe për këtë edhe vota e secilit qytetar ka peshën dhe rëndësinë e vet.




Ne jemi e ardhmja e vendit tonë

NE SHKRUAJMË SE SI TË JEMI QYTETARË AKTIV

LEART (10), LORITA (10), ENDRIT (10), RIDVAN (11), DALINA (10), VALENTINA (10), LAURETA (12)

Ne jemi qytetarë aktiv të Republikës së Kosovës dhe në këtë artikull dëshirojmë t'iu tregojmë juve se si mund të bëheni edhe ju qytetarë aktiv

Ne të gjithë jemi qytetarë të vendit tonë. Varësisht se ku jetojmë secili nga ne ka të drejta, obligime dhe përgjegjësi ndaj vendit që na rrethon. Sa më aktivë që të jemi, aq më më të njohur, më të bukur dhe më të mirë do ta bëjmë shtetin tonë. Ne të gjithë jemi qytetarë sapo t'i hapim sytë, por ne nuk mundemi të votojmë sepse ne nuk jemi mbi moshën 18 vjeçare. Kur të arrijmë moshën 18 vjeçare ne kemi të drejtë të votojmë për kandidatin më të mirë. Ne, fëmijët kemi shumë të drejta. Ne shkojmë në shkollë, luajmë dhe shprehemi lirshëm. Në shkollë, ne duhet të mësojmë dhe t'i kryejmë detyrat. Në shtëpi duhet të kemi shumë respekt ndaj familjes së gjerë dhe familjes së ngushtë. Kur jemi të edukuar mund të arrijmë gjëra të mëdha dhe mund të bëhemi qytetarë sa më të shquar.



Pema e mendimeve tona



Si ta mbajmë mjedisin të pastër




Drejtësia dhe barazia mes racave



Autorët e artikullit



Çdo kush ka të drejtë të votoj dhe të shpreh mendimin e tij



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë